

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

UZ Nr. / Br 1462/22

Nr. l fq. / Br. st _____

Data: / Datum 20. 11. 2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 pika 3 të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera nr. 04/L-027, 44 paragrafi 1 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës me datën 20.11.2022 merr këtë:


VENDIM
PËR NGRITJE TË GATISHMËRISË EMERGJENTE

1. Ngritët gatishmëria emergjente dhe aktivizohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në Komunën e Vushtrrisë për shkak të rrezikut të vërshimeve, pas reshjeve të ditës së sotme.
2. Kërkohet nga Kryetarët e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane të rrezikuara nga vërshimet, që të jenë vigjilent, si dhe të përcjellin situatën në terren dhe t'i koordinojnë veprimet me komunitetin dhe Shtabin për Gatishmëri Emergjente të Komunës, për ndërmarrje të masave të duhura për tejkalim me sa më pak pasoja të gjendjes të krijuar nga vërshimet.
3. Ekonomive familjare, bizneseve etj. të cilat i ekspozohen rrezikut nga vërshimet, në rast nevojë të marrin masa për evakuim të familjarëve, të mirave materiale, si dhe vendosjen e tyre në vende të sigurta.
4. Njësia e Zjarrfikësve dhe QKMF në bashkëpunim dhe koordinim me Policinë e Kosovës, të jenë në gjendje mobile për intervenim, me qëllim të mbrojtjes së shëndetit dhe të mirave materiale.
5. Nga qytetarët kërkohet bashkëpunim në këtë situatë emergjente nga kjo fatkeqësi natyrore.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.
7. Vendimi të shpallët në mjetet elektronike të informimit publik të komunës.



Frit Idrizi

Kryetar i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI



Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe neni 44 pika 3 e Ligjit për Mbrojtje nga fatëkeqësitë Natyrore dhe Fatëkeqësitë tjera nr. 04/L-027, situatës se krijuar në terren Kryetari i komunës merr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIM TË SHTABIT PËR GATISHMËRI EMERGJENTE NË KOMUNËN E
VUSHTRRISE**

1. Me qëllim të ndërmarrjes së masave për tejkalim të gjendjes së krijuar në terren si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut, formohet Shtabi për Gatishmëri Emergjente në këtë përbërje:

1. **Ferit Idrizi -Kryetar i Komunës-së**, kryesues,
2. **Shpetim Zhegrova - Nënkryetar**, zv. Kryesues
3. **Reshat Kovaçi, Komandant i Stacionit Policor**, anëtar
4. **Maliq Ferizi – Drejtor I DMSH-së – anëtar**
5. **Fadil Hyseni, Shef i Nësisë së Zjarrfikësve - anëtar**
6. **Benjamin Shala, Drejtor i DSHP**, anëtar
7. **Nexhmedin Rashica, Drejtor i DSHS**, anëtar,
8. **Ergin Sungur – Drejtor i EBPZHR-anëtar**
9. **Përfaqësuesi i Kryqit të kuq**, anëtar
10. **Shefqet Maloku Menaxheri i KRU Njësia në Vushtrri - anëtar**
11. **Fadil Bahtiri – Kryeshf ekzekutiv – NPL “Pëparimi” SH.A-anëtar**
12. **Përfaqësuesi I Shoqatës e Peshkatarëve – antarë**

2. Shtabi për Gatishmëri Emergjente përcjellë 24 orë situatën në terren, si dhe koordinonë punët dhe veprimet e tij me të gjitha institucionet kompetente komunale

3. Zyra për Informim e Komunës informon qytetarët me kohë lidhur me gjendjen në terren.

4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës